

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 27, datë 09/10/2019

PËR

“MIRATIMIN E PLANEVE MËSIMORE, CIKLI I PARË DHE CIKLI I DYTË TË STUDIMEVE, NË FAKULTETIN E MUZIKËS, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në pikën 1 dhe 2 të nenit 3, pikën 1 shkronjat a, dh dhe f të nenit 38 si dhe të pikave 1, 4 dhe 6 të nenit 39 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; shkresën e Dekanit të Fakultetit të Muzikës mbi dërgimin e planeve mësimore për ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve, për vitin akademik 2019-2020; si dhe në prezantimin e të gjitha programeve të studimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master, për vitin akademik 2019-2020, nga Drejtuesit e Departamenteve dhe pasi e diskutoi,

V E N D O S I:

1. Miratimin e planeve mësimore të Fakultetit të Muzikës, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master, për vitin akademik 2019-2020, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi të dërguar nga Fakulteti i Muzikës.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës, Sekretaria mësimore dhe Sektori mësimor dhe informimit të studentëve.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

